



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-30924/19
Kaçanik, 27.09.2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VIII (Tetë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 27 Shtator 2019. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj me arsye, Hafize Sallahi.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, të gjithë drejtorët e drejtorive, ndërkaq nga zyrtarët ishin: Arbnora Kuka, Bejtulla Dalloshi.

Nga OSBE, mbledhjen e monitoroj, Faruk Dërmaku.

Mbledhja u monitorua përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, Procesmbajtës, Makfëre Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin duke i thirrur emër për emër të gjithë anëtarët e KK. Pjesëmarrës në mbledhje janë, 24 anëtarë, ndërkaq 3 anëtarët tjerë pritët të vijnë në ndërkohë, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VIII-të (Tetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës, për vitin 2019, data 27 Shtator, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin 2020 dhe vlerësimet për vitet, 2021-2022;
3. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2019;

4. Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve buxhetore për realizimin e projektit, Instalimi i rrjetit të ujësjellësit në f. Shtrazë;
5. Informatë e DAK. për fillimin e vitit të Ri shkollor 2019/2020.
6. Informatë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) –për gjashtëmujorin e parë të vitit 2019.

Rendi i propozuar të punës me shtimin e pikës 8-të e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës.

APROVOJ

Rendin e Punës në përbërje prej 6 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes së VII-të (Shtatë) të Rregullt i Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja e VII-të (Shtatë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2019 të datës 30 Korrik 2019 / Lënda: 01Nr. 060/01-22628/19

Kryesuesi i Kuvendit, Para se me kaluar në pikët tjera të rendit të punës, nëse ka kush ndonjë pyetje apo kërkesë, lë të urdhëroj:

Pyetjet dhe Kërkesat

z. Shpend Krusha, Në rrugën, “Vëllezërit Çaka” prej urës e deri të Shkolla e Mesme Profesionale “ Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” ka nevojë për shtimin e policëve të shtrirë, për shkak së auto veturat që po qarkullojnë në atë rrugë e tejkalojnë shpejtësinë e lejuar, gjë që ekziston mundësia të vjen deri të ndonjë fatkeqësi jo vetëm e nxënësve, por edhe të qytetarëve të tjerë që kalojnë atypari.

z. Ekrem Kyçyku, Kam një kërkesë në emër të qytetarëve të f. Glloboçicë për hapjen e një pike të Telekomit të Kosovës, për shkak se ka nevojë ajo pjesë për shkak të largësisë nga qyteti dhe valëve të dobëta. ndërkaq kisha kërkuar që për hapjen e asaj pike me ndikua komuna të organet relevante të Agjencinë përkatës për me u realizuar.

znj. Nazife Krasniqi, Kërkoj të merren veprime të nevojshme nga dikasteri përkatës për pastrimin e Lumit Neredime, pasi lumi po kundërmon rëndë nga papastërtia e tij. Pos kësaj, ka nevojë të pastrohen edhe shtretërit e përrrenjve që përshkojnë qytetin e Kaçanikut. Kam një kërkesë tjetër, komuna në bashkëpunim me Policinë e Kosovës të merr veprime të nevojshme për ndalimin e shpejtësinë së auto veturave që po zhvillohet në rrugën “ Ismajl Raka”. Tjetër, një kërkesë të cilën e kam ngritur edhe më herët është vendosja e një “Laure” të hekurudha e trenit në afërsi të SHM “ Skënderbeu”, sepse kalimi për gjatë hekurudhës në atë pjesë paraqet rrezik për nxënësit e shkollës FSHMU “Emin Duraku”, paralelja në lagjen, “Dushkajë” dhe qytetarëve tjerë. Për këtë kërkesë kemi pasur premtim nga drejtori i DSHPE, së do të bëhet diçka në këtë drejtim, ndërkaq e njëjta ende nuk është realizuar.

z. Bekim Koxha, Objekti i Qendrës së Punësimeve në Kaçanik, që është duke u ndërtuar, i kam pa do foto së si ka me u ndërtuar. Kjo tregon për një mos punë dhe papërgjegjësi të organeve relevante të komunës, sepse me u ndërtua objekti nën telat e energjisë elektrike të tensionit të lartë vetëm 1.6 m kujtoj së nuk është në rregull. Mendoj se komuna duhet me marrë veprime të nevojshme në këtë drejtim, sepse mund të këtë pasoja me rrezikshmëri nga ky ndërtim.

Kryesuesi i Kuvendit, Kërkoj nga z. Bekim Koxha që kërkesën e tij që e ngriti, të dërgoj më shkrim kërkesën e jo të jep komentet e tija në kërkesë.

z. Adnan Reka, Kërkojmë që 'Faturat e Tatimit në Pronë' të rishikohen, sepse kanë gabime në shumën nga 2 deri në 3 euro, me qëllim apo pa qëllim nuk e di, kryesorja duhet të kontrollohen sepse qytetarët nuk i kontrollojnë ato plotësisht, por vetëm i bëjnë pagesat.

z. Selim Reka, Kam një Kërkesë nga një lagje "Rilindja" të f. Begracë lidhur me pjesën e rrugës së tyre, e cila ka ngelur e paasfaltuar. Ata thonë se ajo pjesë e rrugës ka mbetur pa asfaltuar për shkaqe politike.

z. Shemsedin Luzha, Kam një kërkesë nga qytetarët e f. Begracë lidhur me gjendjen kaotike të krijuar në shkollën e Begracës si rezultat i papastërtisë në atë shkollë. Në atë shkollë janë të punësuar tre punëtorë për mirëmbajtjen e objektit shkollor, ndërkaq gjendja e pastërtisë në atë shkollë është e mjerueshme.

znj. Kaltrina Tafili, Unë kam një Kërkesë në emër të qytetarëve të "BK Centër" për zhurmën që po krijohet në rrugën "Ismajl Raka" në orët e vona nga disa lokale që veprojnë në rrugën "Ismajl Raka". Zhurma që krijohet sidomos në orët e vona, është shqetësuese për qytetarët e asaj lagjeje dhe për qytetarët që banojnë në rrugën "Skënderbeu". Është mirë më marrë veprime të nevojshme për ndaljen e zhurmës që po krijohet nga disa lokale që veprojnë në atë pjesë.

Kërkesën në emër të qytetarëve të "BK Centër" për zhurmën që po krijohet në rrugën "Ismajl Raka" në orët e vona,

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kërkesa të tjera, përgjigjet do t'i merrni nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhjen vijuese të Kuvendit të Komunës. Atëherë procedojmë me pikët e radhës të rendit të punës; Kalojmë në pikët vijuese sipas rendit të punës:

2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin 2020 dhe vlerësimet për vitet, 2021-2022;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë me kohë, kjo çështje është trajtuar edhe në mbledhjen e KPF, janë organizuar edhe dëgjime publike ashtu siç e parashohin rregullat ligjore. Drejtori i DEFZH, Bahri Selimi është në fushatë zgjedhore dhe po qëndron pak më larg, pasi që është kandidat për deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, megjithatë nëse keni diçka rreth buxhetit, është edhe Kryetari i Komunës, Besim Ilazi i cili do të jap sqarime të nevojshme. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kycyku, Draft Buxheti është shqyrtuar me kujdese nga LVV dhe kemi vlerësuar së ky buxhet nuk garanton zhvillim ekonomik të komunës, kur dihet se pjesa dërmuese e

buxhetit të komunës shkon për asfalt, ndërkaq në anën tjetër qytetarët e komunës së Kaçanikut dhe disa fshatra të kësaj komune kanë mungesë të ujit të pijes, nevojë jetike kjo. Tjetër, Në këtë buxhet nuk është përfshirë buxheti i përgjithshëm gjinor, që është i garantuar me ligj. Ne do të votojmë kundër këtij planifikim buxhetor, pasi që kemi pasur kërkesa për prioritete në debatet publike të organizuara me qytetarë të komunës, por kërkesat tona nuk janë marrë parasysh.

znj. Nazife Krasniqi, Edhe unë pajtohem me parafolësin tim se investimet kapitale më këtë buxhet shihet se po shkojnë më tepër në asfalt, kur dihet se komuna jonë ka shumë prioritete të tjera me të nevojshme sesa asfalti, si çështja e pastrimit të lumenjve, ashtu që me marrë veprime që kanalizimet mos me u derdhur në lumenjtë. Tjetër, nuk i është dhënë hapësirë buxhetimit të përgjithshëm gjinor në ndonjë projekt. Të mjetet për investime kapitale të DSHPE, shihet se pjesa dërmuese e mjeteve shkojnë në asfalt. Unë nuk jam kundër asfaltit, por pse mos më i dhënë prioritet një fushe tjetër ku kemi nevoja të tjera më të mëdha. Duke u nisur nga këto që i theksova, unë jam kundër këtij planifikim buxhetor të propozuar.

z. Bekim Koxha, Edhe në komuniteti i f. Koxhaj kemi pasur kërkesa për prioritete për projekte të caktuara, dhe të njëjtat i kemi ngritur në dëgjimet publike me qytetarë, por të njëjtat nuk janë marrë parasysh. Ka pasur edhe prioritete të këtij komuniteti edhe në planifikimet buxhetore paraprake, por që të njëjtat nuk janë realizuar ende.

z. Shpend Krusha, Unë kam vërejtje për mjetet e ndara për prioritete në sektorin e Bujqësisë, në shumë 50.000.00€, kur dihet nevojat për zhvillimin e këtij sektori janë shumë të mëdha. Shtrohet pyetja, si mund të zhvillohet ky sektor më vetëm këtë shumë buxhetore të ndarë.

z. Ekrem Raka, Identifikoj një gabim teknik në material, ku shënohet buxheti për vitin 2019, duhet të jetë për vitin 2020, ndërkaq shtoj së nuk kam marrë pjesë në dëgjime publike me qytetarë të komunës për çështjen e buxhetit të komunës, për shkak së, mënyra si po planifikohet buxheti i komunës, pothuajse është gati e njëjtë nga vitet paraprake, me disa ndryshime kozmetike. Mundësia për me ndryshuar diçka nga buxheti i planifikuar si po shihet nuk ka, kështu që ju (partia në pushtet) i keni votat dhe mund të veproni ashtu si doni ju.

Kryesuesi i Kuvendit, Buxheti i planifikuar nuk mundemi me thënë se është kozmetik, kur dihet se janë marrë parasysh kërkesat e anëtarëve të KK, por edhe kërkesat e komuniteteve. Në debatet publike të organizuara me qytetarë, është parë se pjesa dërmuese e kërkesave të komuniteteve ka qenë për asfaltimin e rrugëve. Ndoshta ju keni ndonjë opinion tjetër të qytetarëve, por kërkesat të cilat janë ngritur në debate publike me qytetarë, kanë qenë për infrastrukturë rrugore. Ka pasur edhe kërkesa të tjera, por pjesa dërmuese e tyre kanë qenë për asfaltimin e rrugëve. Janë trajtuar kërkesat e komuniteteve dhe të anëtarëve të KK dhe disa nga to janë marrë parasysh, ndërkaq është e drejtë e secilit sesi e trajton çështjen e buxhetit se tani jemi në kohë fushate. Unë mendoj se gjatë diskutimeve të jemi më konkret e cilat projekte nuk duhet me qenë në këtë planifikim buxhetor dhe ne jemi këtu me shikuar se çka mund të ndryshojmë dhe plotësojmë, e jo me qenë kundër se nuk është planifikuar mirë buxheti. Mirë është më dalë me propozime konkrete. Këto gjëra na kanë munguar edhe gjatë debatit publik me qytetarë të komunës.

z. Selim Reka, Ne edhe në KPF i kemi ngritur disa kërkesa për projekte kapitale dhe në debate publike me qytetarë, ndërkaq një kërkesë është marrë parasysh- çështja e ujësjellësit,

por jo edhe aq shumë sa me pasur mundësi me u realizuar për dy vite çështja e ujit të pijes. ndërkaq kërkesat tjerat nuk janë marrë parasysh. Ne qëndrojmë përsëri pranë kërkesës tonë që prioritet mbi prioritetet dihet se është çështja e ujit të pijes. Disa prioritete mund të presin tutje, si rregullimi i trotuarit në rrugën Bob- Doganaj, pastaj projektet e ndriçimi publik, ndërkaq çështja e ujit të pijes është një projekt që nuk mund të lëmë për më vonë. Ne, subjekti politik i LDK kishim me qenë Për, nëse shtohen mjete buxhetore ende për projektin e ujit të pijes dhe nëse hynë në prioritet, Rregullimi i sallës së vogël të shtëpisë së kulturës” Xheladin Kurtaj” në Kaçanik.

Kryetari i Komunës, Pajtohem më kërkesat e juaja, por buxheti i komunës është simbolik, ndërkaq dihet se nevojat e prioriteteve janë të mëdha. Dëgjimet publike me qytetarët e komunës janë mbajtur ashtu si e parashohin rregullat ligjore në mënyrë që me i bërë orientimin e prioriteteve. Përfaqësuesit e komuniteteve duhet me bërë orientime të prioriteteve për komunitetet e tyre aty ku janë më të nevojshme dhe më të arsyeshme, ndërkaq nga prioritetet ka pasur kërkesa të komuniteteve për asfaltimin e rrugëve. Unë e kam pranuar kërkesën e z. Selim Reka për çështjen e shtimit të kapacitetit të ujit të pijes, ky projekt është koduar, ndërkaq dihet se mjetet e ndara nuk janë të mjaftueshme për realizimin e këtij projekti, mirëpo mendohet ne fondet e bashkëfinancimit, sepse buxheti i komunës është i vogël më mbuluar shumë prioritete. Kur jemi të prioritetet infrastrukture të rrugëve, ka lagje që ende në asfalt, ndërkaq, nëse ju e shihni të arsyeshme me u hequr ndonjë prioritet si në listë dhe me futur ndonjë tjetër, atëherë urdhëroni.

z. Bekim Koxha, Orientimet e prioriteteve me këtë planifikim buxhetor janë bërë në ato vende të cilat janë bastion i partisë në pushtet-PDK, ndërkaq f. Koxhaj ka mungesë të ujit të pijes - nevojë jetike e qytetarëve të komunitetit në fjalë. Kjo çështje është ngritur edhe në Debatet publike me qytetarë të komunës. Tjetër, vetëm 50,000.00€ janë ndarë për sektorin e bujqësisë, e që kjo shumë është shumë e vogël për me realizuar ndonjë projekt në këtë sektor.

z. Sali Malsiu, Për z. Bekim Koxha, Kur jemi të orientimet buxhetore për prioritete në komunitetet të cilat janë bastion i partisë në pushtet, atëherë me tregoni mua sa mjete buxhetore janë ndarë për prioritete të f. Dubravë, fshat ky i cili thuhet se është bastion i partisë në pushtet- PDK?.

z. Bekim Koxha, Nuk ka çka të investohet më në f. Dubravë, sepse ky komunitet i ka të gjitha projektet e realizuara.

z. Shemsedin Luzha, Në f. Begracë, ujë të pijshëm ka, ndërkaq është nevojë e madhe për ndërtimin e një fushe sportive.

Kryetari i Komunës, Në f. Begracë parashihet me u ndërtuar salla e sporteve. Ky projekt mendohet të kryhet nga komuna në bashkëpunim me ju dhe në gjetjen e ndonjë donacioni.

z. Shemsedin Luzha, Kërkesat janë të qytetarëve të f. Begracë e jo të miat, kërkesat kanë ekzistuar kaherë, mirëpo komuna nuk i ka marrë parasysh.

z. Ekrem Kyçyku, Mënyra se si planifikohet buxheti është ashtu siç e parasheh qeveria. Debate publike me qytetarë janë organizuar dhe mbajtur, ndërkaq kërkesat tona nuk janë marrë të gjitha parasysh. Nëse e bëjmë një analizë të buxhetit të planifikuar, shihet së buxheti i planifikuar për tre vite shihet se më tepër shkon në infrastrukturë rrugore, në ato

komunitete ku partia në pushtet. Me u pa dëgjuar unë, ishin bërë investime në projekte në Zonat ekonomike industriale dhe në Sektorin e kulturës.

z. Ramadush Osmani, Unë nuk pajtohem së buxheti i planifikuar për tre vitet vijuese ka shkuar në infrastrukturë rrugore. Nga 60 kode të projekteve, 10 prej tyre shkojnë në infrastrukturë. Infrastruktura nuk nënkupton së është vetëm rrugë, por përfshinë ujësjellës, kanalizim etj. Nëse i analizojmë projektet në turizëm, nuk është investimi në infrastrukturë rrugore. Të çështja e rregullimit të shtretërve të lumenjve dhe përroskave, ka probleme procedurale, përfshirë edhe pjesën e përroit në lagjen “Mejdi Dalloshi” dhe lagjen në f. Bob, ndërkaq të njëjtat kanë me u rregulluar nëse zgjidhen këto probleme. Projekti i Ujësjellësit ka kaluar, dhe nuk do të ndalem vetëm më kaq, sepse edhe mjetet e bartura nga viti 2019 të shikojmë së ku do t’i bartim. Propozimet për mjetet e bartura nga vitet e kaluara vijjnë këtu dhe ju vendosni. Të kanalizimet fekale, ne jemi duke hartuar projektin e kanalizimeve fekale të f. Begracë në tre drejtime. Të Trotuaret, trotuaret të cilat kanë hyrë në prioritet në këtë planifikim buxhetor janë të arsyeshme dhe të nevojshme. Në rrugën “ Avdyrrahim Shehu” ka me u bërë zgjerimi i rrugës dhe ndriçimi publik. Të disa kërkesa të cilat u potencuan, si asfaltimi i rrugës “ Rilindja” kjo rrugë është e asfaltuar.

z. Ekrem Kyçyku, Është e vërtetë se në prioritetet e DSHPE janë paraparë 10 projekte në infrastrukturë rrugore, por jo edhe në drejtoritë tjera.

z. Adnan Reka, Në lagjen “Avdyrrahim Shehu” unë nuk shoh se keni ndarë mjete financiare për këtë rrugë as për vitin 2020, as 2021, përveç se e keni futur si kod buxhetor. Meqë po thoni se keni planifikuar projekte në turizëm, a mund te me tregoni drejtor, sa mjete buxhetore janë ndarë për menaxhimin e mbeturinave në zonat turistike, derisa ju keni thënë se këtë vit i kemi shpallur luftë mbeturinave, për çfarë lufte po flisni, ne jemi gati në fund të vitit dhe nuk po shohim asnjë përmirësim të gjendjes së mbeturinave, apo ndoshta e keni lënë për natën e vitit të ri të bëni luftë me fishekë zjarre.

z. Ekrem Raka, Kryesues, mos u mendo me e nxitë debatin duke e mbrojtur ekzekutivin e komunës. Ju jeni Kryesues i KK për të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në KK e jo vetëm për subjektin politik të PDK, kështu që në çështjet të cilat i ngritëm ne, mos e merrni rolin e ekzekutivit me na dhënë sqarime të nevojshme këtu, sepse janë përfaqësuesit e organeve të ekzekutivit për me na dhënë përgjigje të nevojshme në çështjet që ngritën.

Kryesuesi i Kuvendit, Unë jam Kryesues i Kuvendit dhe askujt këtu në Kuvendit të Komunës, ndërkaq askujt nuk ia kam mohuar të drejtën e marrjes së fjalës. Unë po e themi atë që është debatuar në Debat publike me qytetarë dhe ju nuk keni marrë pjesë në debate të organizuara me qytetarë të komunës për çështje e buxhetit të komunës.

z. Bekim Koxha, Unë si anëtar i Kuvendit të Komunës e kam obligim me marrë pjesë në mbledhje të KK, më diskutuar me i ngritur çështjet në emër të komuniteteve dhe askush nuk mundet me ma marrë këtë të drejtë me diskutuar. Nëse mendoni kështu me e udhëheq mbledhjen, atëherë unë mundem me u tërhequr nga mbledhja.

z. Shemsedin Luzha, Sa po e shoh unë Kryesuesi i Kuvendit nuk ka anime nga asnjë subjekt politik. Ata që po e nxisim situatën jemi në anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Planifikimin e Buxhetit të Komunës për vitet 2020-2022 e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 14 votë Për, 8 votë Kundër dhe 4 votë Abstenime. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2020 dhe vlerësimet për vitet, 2021-2022 / Lënda : 01Nr. 400/01-30433/19.

3. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Drejtori i DEFZH, është prezentë në mbledhje, mirëpo pasi është kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës s Kosovës, po qëndron më i rezervuar, kështu për sqarime të nevojshme fjalën e ka drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani.

z. Ramadush Osmani, Theksoj së për shkak të mungesës së rishikimit buxhetor të vitit 2019, të komunës, po detyrohemi me bërë rialokim të mjeteve buxhetore të projekteve kapitale etj. Në vazhdim drejtori sqaroj për shumat e mjeteve buxhetore që rialokimin, paraqitur në Propozim Vendim që rialokohen dhe arsyen e rialokimit të tyre.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 17 votë Për, Kundër ishin 6, ndërkaq Abstenuan 2 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për Rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2019 / Lënda: 01Nr. 400/01-30460/19.

4. Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve buxhetore për realizimin e projektit, Instalimi i rrjetit të ujësjellësit në f. Shtrazë:

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për lejimin e mjeteve buxhetore për realizimin e projektit, Instalimi i rrjetit të ujësjellësit në f. Shtrazë / Lënda: 01Nr. 400/01-30599/19.

5. Informatë e DAK, për fillimin e vitit të Ri shkollor 2019/2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Të dhënat e paraqitura si në informatë janë reale. Sivjet është shqetësuese rënia e numrit të nxënësve e në veçanti në shkollat e mesme, ashtu që edhe pse është ulur kriteret e regjistrimit, në këtë vit shkollor kemi nxënës të regjistruar për 2 klasë më pak. Unë kujtoj se nuk është gjithë arsyeja e migrimit të nxënësve në diasporë, por disa nxënës të komunës tonë po regjistrohen në shkollat e mesme në komunat tjera, për shkak të afërsisë

së shkollës dhe disa për shkak se në shkollat e komunës tonë nuk i kemi drejtimet për të cilat janë të interesuar me u regjistruar.

z. Adnan Reka, Fillimisht me lejoni t'ju përgëzoj për një raport të qartë dhe të saktë, por kritika ime mbetet tek renditja e prioriteteve.

Shkolla në Kovaçec ishte premtim elektoral që nga viti 2017, pastaj premtimet vazhduan se do të përfundojë në vitin 2018, e tani jemi në fund të vitit 2019 ende me premtime e me shpresë se tanimë nuk ka ku të shkojë, do të përfundoj. A nuk ju duket e tepruar?

Përveç objektit të ri shkollor, kjo shkollë përballet edhe me menaxhim jashtëzakonisht të keq të cilin duhet ta themi troç, dhe ja se si:

Ju, në raportin tuaj thoni se të gjithë fëmijët nga klasa 1 deri në klasën 7 janë të pajisur me tekste mësimore, ndërsa klasën e 8 dhe të 9 janë të pajisura pjesërisht, unë them jo Drejtor dhe këtë mund ta konfirmoj, së paku për tekstet e Gjuhës Angleze dhe Gjermane, në shkollën e Kovaçecit nga klasa e 1 deri në klasa 7 janë të pajisur pjesërisht me tekste, ndërsa për klasën e 8 dhe 9 nuk ka fare (asnjë) tekst të Gjuhës Angleze dhe Gjermane, e kjo gjë nuk vlen për shkollën amë e cila është plotësisht e pajisur me tekste mësimore, prandaj unë them se është diskriminim apo menaxhim shumë i keq, të cilën gjë lehtë mund ta verifikoni.

Kur them kritika ime mbetet tek renditja e prioriteteve, kam parasysh tendencën e rënies së numrit të nxënësve nëpër institucione shkollore, që për këtë vit ju thoni se është 16 nxënës më pak se në vitin e kaluar, ndërsa unë them po ta shikojmë shkollën e Kovaçecit në 3 vitet e fundit tregon se ka rritje për 3 nxënës në vit. Në vitin shkollorë 2016/17 kishte të regjistruar 16 nxënës në para fillor, në vitin 2017/18, 19 nxënës, dhe në këtë vit 2019/20 kemi 21 nxënës, duke e hequr lagjen Trupaj që është pjesë e fshatit Kovaçec, por që shumica e nxënësve të kësaj lagje regjistrohen në shkollën amë, kuptohet për kushte më të mira. Tani unë pyes a nuk duhet të investohet më tepër aty ku fatmirësisht kemi rritje të numrit të nxënësve, e jo pasi të filloj të bie numri i nxënësve sepse atëherë është vonë të rikthehet interesimi i tyre.

z. Shpend Krusha, Çështja e vendosjes së një "Laure" të hekurudha e trenit në afërsi të SHM "Skënderbeu" të cilën e përmendi Nazifja është nevojë urgjente e cila nuk pret. Lidhur me këtë çështje, unë kam bërë kërkesë ka kohë në mbledhje të KK, ndërkaq nuk kam marrë ndonjë përgjigje as gojore e as në formë të shkruar. Nëse ndodhë ndonjë fatkeqësi, atëherë ta kenë parasysh së ju jeni përgjegjës. Më intereson të di, a është marrë ndonjë veprim për këtë çështje, a kenë dërguar ndonjë kërkesë ministrisë së linjës? Ekziston mundësia me ndodhur ndonjë fatkeqësi në atë vendkalim të hekurudhës, kështu që duhet vepruar sa nuk është bërë vonë.

z. Bekim Koxha, Me intereson të di, çka u bë për çështjen e teatrit të qytetit të Kaçanikut. Tjetër, Çka u bë me shkollën e f. Koxhaj, çka është investuar në infrastrukturën e saj, sepse shënohet së është investuar në infrastrukturë të shkollës.

z. Ekrem Raka, Nga planifikimi buxhetor shihet së, 220.000.00€ janë ndarë për Investime Kapitale, prej tyre 6 projekte janë me nga 5.000€. Unë mendoj së duhet me u ndarë më tepër mjete buxhetore për Arsim dhe për Shëndetësi, sepse shumica e ndarë është e pamjaftueshme. Nevojat janë të shumta në secilin sektor, por prioritet mbi prioritet duhet me iu dhënë, sektorit të arsimit dhe të sektorit të shëndetësisë.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë, **konstatoj se Kuvendi i Komunës përmes kësaj Informatë të DAK, u njoftua për fillimin e vitit të Ri shkollor 2019/2020;**

6. Informatë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) –për gjashtëmujorin e parë të vitit 2019.

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e kenë marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Duhet me bërë një analizë se sa Kërkesa iu kanë drejtuar KKSBB dhe sa nga to janë realizuar. Ne kemi një kërkesë të SHM “ Skënderbeu” sepse është e pamundur me u mbajtur procesi mësimor në këtë shkollë, për shkak të zhurmës së krijuar nga kafiteritë. Ditëve të fundit po sillen edhe huliganet, gjë që mund të paraqesin rrezik për nxënësit dhe qytetarët tjerë të komunës. Është njoftuar policia , mirëpo gjendja nuk ka ndryshuar.

z. Ekrem Kyçyku, Nga Raporti shihet se KKSBB nuk e ka debatuar çështjen e ndotjes së lumit neredime. Kjo çështje duhet të debatohet nga ky këshill dhe të bëhet diçka në këtë drejtim.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj së,

Kuvendi i Komunës përmes Informatës së Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), u njoftua me aktivitetin Këshillit–për gjashtëmujorin e parë të vitit 2019.

Në fund, Kryesuesi i Kuvendit, kërkoj nga Ekzekutivi i Komunës që për mbledhjet tjera, kërkesat të cilat ngritën, të iu japin përgjigje aty për aty apo me shkrim. Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e kuvendit të përfunduar. Ora e përfundimit të mbledhjes, 12:13. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 26 anëtarët sa ishin prezent në mbledhje në fillim.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

M Malsiu



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);

nga Mbledhja e VIII (Tetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2019, mbajtur me 27 Shtator 2019.

1. Kemal Mërseli..... _____,
2. Hamid Guri..... _____,
3. Ahmet Luma _____,
4. Kadri Krivenjeva..... _____,
5. Besim Vishi..... _____,
6. Sali Malsiu..... _____,
7. Lirije Shurdhani..... _____,
8. Pranverë Loku- Zharku..... _____,
9. Lirije Luta..... _____,
10. Vlora Dalloshi..... _____,
11. Nexhat Loku _____,
12. Shpend Krusha..... _____,
13. Adnan Reka..... _____,
14. Ekrem Kyçyku..... _____,
15. Fatijona Kyçyku..... _____,
16. Kaltrina Tafili _____,
17. Selim Reka..... _____,
18. Besnik Salihu..... _____,
19. Nazife Krasniqi..... _____,
20. Arlinda Rakoci-Raka..... _____,
21. Shemsedin Luzha..... _____,
22. Albana Troni..... _____,
23. Afërdita Shehi..... _____,
24. Hajredin Luta..... _____,
25. Hafize Sallahi _____,
26. Bekim Koxha..... _____,
27. Ekrem Raka..... _____,



Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 16. 10. 2019-

Për: Anëtarët e Kuvendit: z. Shpend Krusha
znj. Nazife Krasniqi
z. Selim Reka

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruara para Kuvendit të Komunës, më datë 27. 09. 2019, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

z. Shpend Krusha, Në rrugën, "Vëllezërit Çaka" prej urës e deri të Shkolla e Mesme Profesionale "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" ka nevojë për shtimin e policëve të shtrirë, për shkak së auto veturat që po qarkullojnë në atë rrugë e tejkalojnë shpejtësinë e lejuar, gjë që ekziston mundësia të vjen deri të ndonjë fatkeqësi jo vetëm e nxënësve, por edhe të qytetarëve të tjerë që kalojnë atypari.

- *Drejtoria e Shërbimeve Publike ka të planifikuar vendosjen e barrierave (policëve të shtrirë) në afërsi të objekteve shkollore dhe në segmentet rrugore ku vlerësohet si e nevojshme për shkaqe sigurie të këmbësorëve në komunikacion. Posa të lidhet kontrata me operatorin ekonomik do të fillohet implementimi i këtij projekti bazuar në planifikimet e drejtorisë.*

znj. Nazife Krasniqi, Kërkoj të merren veprime të nevojshme nga dikasteri përkatës për pastrimin e Lumit Neredime, pasi lumi po kundërmon rëndë nga papastërtia e tij. Pos kësaj, ka nevojë të pastrohen edhe shtretërit e përrrenjve që përshkojnë qytetin e Kaçanikut. Kam një kërkesë tjetër, komuna në bashkëpunim me Policinë e Kosovës të merr veprime të nevojshme për ndalimin e shpejtësinë së auto veturave që po zhvillohet në rrugën "Ismajl Raka". Tjetër, një kërkesë të cilën e kam ngritur edhe më herët është vendosja e një "Laure" të hekurudha e trenit në afërsi të SHM "Skënderbeu", sepse kalimi për gjatë hekurudhës në atë pjesë paraqet rrezik për nxënësit e shkollës dhe qytetarëve tjerë. Për këtë kërkesë kemi pasur premtim nga drejtori i DSHPE, së do të bëhet diçka në këtë drejtim, ndërkaq e njëjta ende nuk është realizuar.

- *Pastrimi i lumit Neredime bëhet çdo vit nga punëtorët sezonal të angazhuar nga DSHPE-ja, kurse rreth kundërmimit të saj, të gjithë jemi në dijeni së është si pasojë e derdhjes së ujrave fekale nga komuna e Ferizajit dhe pjesës së fekaleve nga Kaçaniku i Vjetër deri në zonën urbane të qytetit. Për pjesën e komunës së Kaçanikut, jemi në hartim të projektit për vendosjen e kolektorëve për largimin e ujrave fekale deri në periferi të qytetit, ku planifikohet ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujrave të zeza.*


- *Rruga "Ismajl Raka" është në zonën urbane dhe e përcaktuar me ligj se sa është kufizimi shpejtësisë në vendbanim.*
- *Qështja e nevojës së vendosjes së një laure në afërsi të objektit të ETC-së te kryqëzimi i rrugës "Skenderbeu" dhe "Emsale Frangu" është ngritur si qështje në Drejtorinë e Hekurudhave të Kosovës, pasi që kjo është në përgjegjësi të këtij organi, me theks të veçant rrezikun potencial gjatë kalimit të hekurudhës prej nxënësve që gravitojnë këtë segment rrugor gjatë shkuarjes dhe kthimit të tyre në shkollë. Gjithashtu, kjo qështje është ngritur dhe debatuar edhe në takimet e rregullta të KKSb-së. Ne si drejtori, kemi marrë masat në vendosjen e shenjave të vendkalimit hekurudhor si masë preventive në këtë udhëkryq hekurudhë-rrugë.*

z. Selim Reka, Kam një Kërkesë nga një lagje " Rilindja" të f. Begracë lidhur me pjesën e rrugës së tyre, e cila ka ngelur e paasfaltuar. Ata thonë se ajo pjesë e rrugës ka mbetur pa asfaltuar për shkaqe politike.

- *Kjo rrugicë, si shumë rrugica të tjera, planifikohen të realizohen në kuadër të projektit "Rregullim dhe asfaltim i rrugëve lokale", projekt i planifikuar edhe në buxhetin e vitit fiskal 2020.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,


 Ramadush Osmani
 Drejtor i DSHPE-së